

Emri i Lëndës : Historia e Shqipërisë

| Kodi | Tipi i lëndës | Semestri | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
|---|---------------|----------|---|---------------------|----------------|---------|------|
| HST 101 | B | 1 | 3 | 0 | 0 | 3.00 | 4 |
| Lektori dhe orari i konsultimeve | | | Hasan Bello, PhD | | | | |
| Asistenti dhe orari i konsultimeve | | | | | | | |
| Gjuha e kursit | | | Albanian | | | | |
| Niveli i lëndës | | | Bachelor | | | | |
| Përshkrimi | | | Historia e Shqipërisë trajton ngjarje e dukuri historike që fillojnë nga kohët e lashta (parahistoria) e përfundojnë në ditët e sotme. Ky program bën të mundur njohjen e studentëve me historinë e popullit shqiptar nga kohët e vjetra dhe deri në ditët e sotme. Përmbajtja akademike e këtij programi përqendrohet në një sërë periudhash duke filluar nga: Antikiteti, Mesjeta, Rilindja Kombëtare, pavarësia, periudha komuniste dhe ajo bashkëkohore. | | | | |
| Objektivat | | | Pas përfundimit të kursit synohet që studentët të jenë të aftë ; -Të njihen me historinë e popullit shqiptar nëpërmjet ngjarjeve dhe fakteve të shqyrtuara gjatë këtij programi. -Të kuptojnë ndodhitë me të rëndësishme historike. - Të jenë të hapur ndaj pikëpamjeve të ndryshme të shfaqura ndaj zhvillimeve historike të periudhave të. caktuara duke debatuar mbi bazën e argumentave shkencore. -Të përcaktojnë kriteret dhe karakteristikat e çdo periudhe si dhe të vendosin një raport më të drejtë , ndërmjet aspekteve të zhvillimeve politike, sociale nga njëra anë dhe ekonomike, kulturore nga ana tjetër. Pas përfundimit të kursit synohet që studenti të jetë në gjendje që : - Të evidentojnë vendimet e marra në Konferenca të ndryshme në dëm të vendit tonë. -Të kuptojnë sakrificat që dha kombi për të mbrojtur dhe ruajtur trevat e tij. -Të analizojnë nëpërmjet projekteve, shqyrtimeve tematike duke kuptuar karakteristikat e qytetërimeve të hershme në vendin tonë. -Të vlerësojnë rolin e e atdhetarëve shqiptarë duke analizuar veprimtarinë e tyre për shpëtimin e atdheut | | | | |

Programi i Lëndës

| Java | Tema |
|-----------|--|
| 1 | Shteti shqiptar në vitet 1912-1914 a) Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimi i qeverisë Kombëtare të Vlorës b) Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912-1913 c) Situata në Shqipëri pas Konferencës së Londrës . d) Veprimtaria e KNK dhe rrëzimi i qeverisë së Vlorës. |
| 2 | Shqipëria nën drejtimin e Princ Vidit a) Princ Vidi pranon kurorën e Shqipërisë b) Administrimi i Shqipërisë së Jugut c) Kryregritja kundër Princ Vidit |
| 3 | Shteti Shqiptar në Luftën e Parë Botërore a) Shqipëria arene lufte b) Traktati i fshehte i Londrës c) Mbarimi i Luftës dhe Kongresi i Durrësit |
| 4 | Shqipëria në Konferencën e Paqes a) Shqipëria në kuadrin e çështjes Adriatikut b) Kongresi i Lushnjës c) Lufta e Vlorës |
| 5 | Shteti i ri shqiptar, sfidat e tij dhe diaspora shqiptare në Amerikë a) Shqipëria në vitet 1920-1924 b) Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve c) Sfidat e shtetit shqiptar (prill 1921-dhjetor 1924) d) Zogu në krye të qeverisë |
| 6 | Lëvizja e Qershorit dhe Qeveria e Fan Nolit a)Përmbysja me dhunë e Ahmet Zogut b)Qeveria e Fan Nolit |
| 7 | Republika shqiptare (1925-1928) a)Sfidat e para të Zogut President b) Kundërshtarët e Zogut nisin organizimin |
| 8 | Provim Gjysmëfinal |
| 9 | Monarkia Shqiptare a)Shpallja e Monarkisë b)Politika e jashtme e Mbretit Zog c)Lëvizjet politike kundër tij d)Qeveria Liberale e Mehdi Frashërit |
| 10 | Shqipëria gjatë Luftës Dytë Botërore a) Pushtimi Italian i Shqipërisë b)Pushtimi Gjerman dhe rezistenca kundër tij |

| | | | |
|---|---|--|------------------------------|
| 11 | Shqipëria gjatë regjimit Komunist a) Shqipëria në periudhën 1944-1960 b) Marrëdhëniet e Shqipërisë me jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik c) Orientimi marksist i ekonomisë | | |
| 12 | Instalimi i Stalinizmit a) Triumfi i vijës së ashpër në gjirin e PPSH-së b) Orientimi i politikës së jashtme drejt Bashkimit Sovjetik c) Kriza në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike | | |
| 13 | Orientimi Kinez i Shqipërisë a) Revolucioni kulturor kinez vjen edhe në Shqipëri b) Ndërtimi dhe Prishja e Miqësisë me Kinën c) Mbështetja kineze e ekonomisë shqiptare | | |
| 14 | Periudha e izolimit të Shqipërisë a) Vitet e fundit të sundimit të Enver Hoxhës b) Shqipëria gjatë viteve 90' c) Fundi i regjimit komunist dhe vendosja e pluralizmit politik | | |
| 15 | Shqipëria në viet e tranzicionit. (Periudha postkomuniste) a) Shqipëria në periudhën pas viteve 90. b) Restaurimi i shtetit (1997-1998) c) Zhvillimet ekonomike në vitet 1991-2001 d) Rrugëtimi i Shqipërisë drejt aderimit në BE | | |
| 16 | Provim Final | | |
| Parakushtet | | | |
| Literatura | | <ul style="list-style-type: none"> • Histori e Shqipërisë 1912-2000, Valentina Duka, ShBLSh, (2007) • Historia e popullit shqiptar, Vëll. III, Toena, Tiranë. (2007) | |
| Referenca të tjera | | <ul style="list-style-type: none"> • Kristo Frashëri Histori e qytetërimit shqiptar (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së dytë botërore), Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë (2008) • A. Puto, Shqipëria Politike 1912-1939, Toena, (2009) • B.J. Fischer, Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri, Çabej, (2000) • Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare, AIIIS, (2013) | |
| Punë laborator | | | |
| Përdorimi i komp. | | | |
| Të tjera | | | |
| Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat | | | |
| 1 | Përmbajta e këtij programi ka si karakteristike njohjen e studentëve me historinë e popullit të tyre. | | |
| 2 | Aftësitë praktike dhe teknike të përfituara nga ky program jepen nëpërmjet punimeve me nivel të lartë gjuhësor dhe shkencor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). | | |
| 3 | Aftësitë profesionale të studenteve do të zhvillohen nëpërmjet nxitjes së të vështruarit kritik të fakteve dhe ngjarjeve të periudhave të ndryshme historike. | | |
| Mënyra e Vlerësimit të Lëndës | | | |
| Notat e Ndërmjetme | | Sasia | Përqindja |
| Gjysmë finale | | 1 | 30 |
| Kuize | | 0 | 0 |
| Projekte | | 1 | 10 |
| Projekte semestrale | | 0 | 0 |
| Punë laborator | | 0 | 0 |
| Pjesëmarrja në mësim | | 1 | 10 |
| Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final | | | 50 |
| Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final | | | 50 |
| Total | | | 100 |
| Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit) | | | |
| Aktivitetet | Sasia | Kohëzgjatja (orë) | Ngarkesa Totale (orë) |

| | | | |
|--|----|----|------------|
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16 | 3 | 48 |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj) | 14 | 2 | 28 |
| Detyra | 1 | 0 | 0 |
| Gjysmë finale | 1 | 10 | 10 |
| Provimi final | 1 | 14 | 14 |
| Të tjera | 0 | 0 | 0 |
| Ngarkesa totale e orëve | | | 100 |
| Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë) | | | 4 |
| ECTS | | | 4 |